

Vendim nr. 252 datë 09.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 09.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (G) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GEN TOTA, përfaqësuar nga avokat Erion Muka, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1761, datë 24.10.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe i vendimeve të gjykatave më të ulëta përkatëse, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rigjykim.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 2015 kërkesi është proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për kryerjen e veprave penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Kultivimi

i bimëve narkotike”, të parashikuara respektivisht nga nenet 283, paragrafi 2 dhe 284, paragrafi 2, të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2017-1322 (163), datë 21.03.2017, ka vendosur deklarinin fajtor të tij, sipas akuzave, duke e dënua përfundimisht me 11 vjet burgim. Gjykimi është zhvilluar me procedurë të zakonshme dhe në mungesë të kërkuarit, interesat e të cilit janë mbrojtur nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata.

2. Ndonëse kërkuari ka paraqitur ankim, vendimi i dënimit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 10-2018-193, datë 27.07.2018, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1761, datë 24.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të tij.

3. Në datën 29.04.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 07.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

4. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore i kanë cenuar:

- 4.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e gjykatës së paanshme*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi trupi gjyqësor i gjykatës së apelit nuk ka përmblusur standardin e gjykatës së pavarur, të paanshme dhe të caktuar me ligj. Tre gjyqtarët që kanë gjykuar themelin e çështjes kanë dhënë vendim edhe për masën e sigurimit të caktuar ndaj tij.
- 4.2. *Të drejtën për të mos u deklaruar fajtor bazuar në provat e mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi gjykatat e zakonshme kanë konsideruar prova deklarimet hetimore të bashkëpunëtorëve të veprës penale, që nuk konfirmohen nga prova të tjera. Njohja e kërkuarit është bërë me anë të fotografive, duke shkelur parashikimet e nenit 172 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Hetimi i çështjes nuk ka qenë i thelluar, pasi kërkuari nuk është marrë në pyetje gjatë hetimit paraprak, gjurmët e gishtave të tij nuk përputhen me ato që janë mbledhur, përgjimi ambiantal i datës 30.10.2015 nuk lidhet me emrin e kërkuarit, por me një shtetas tjetër të arrestuar, i cili njihet me të njëjtin emër me kërkuarin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

5. Çështja e legjitimit (locus standi) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

6. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kundërshton procesin gjyqësor në të cilin është vendosur për akuzën penale ndaj tij, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

7. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

8. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 14.01.2025, ndërsa ankimi individual kushtetues është paraqitur në datën 29.04.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

9. Në drejtim të legjitimit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e gjykatës së paanshme, si dhe të drejtën për të mos u deklaruar fajtor bazuar në provat e mbledhura në mënyrë të paligjshme. Këto të drejta garantohen nga nenet 42 dhe 32, pika 2, të Kushtetutës, pra *prima facie* janë me natyrë kushtetuese, ndaj Kolegji do t’i analizojë në vijim.

10. Në lidhje me të drejtën për gjykim nga një gjykatë e paanshme, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimave nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Gjykata merr

parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv (shih vendimet nr.19, datë 04.04.2023; nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në çështjen konkrete, kërkuesi ka pretenduar se gjyqtarët e gjykatës së apelit, që vendosën për fajësinë e tij, kanë dhënë vendim edhe për masën e sigurimit ndaj tij, pasi ata nuk kanë plotësuar standardin kushtetues të gjykatës së paanshme dhe të caktuar me ligj. Sipas tij, përbërja e trupit gjykues bie ndesh me nenin 15, pika 2, të KPP-së, që parashikon se gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim nuk mund të marrë pjesë në gjykim.

12. Kolegji vëren se çështja penale e fajësisë së kërkuesit është regjistruar në Gjykatën e Apelit Korçë në datën 04.04.2017. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së dytë kërkuesi ka paraqitur kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit, e cila është marrë në shqyrtim dhe është rrëzuar nga i njëjti trup gjykues që po shqyrtonte apelin e tij për themelin e çështjes dhe që në përfundim të gjykimit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të fajësisë. Pas përfundimit të gjykimit në gjykatën e shkallës së dytë, kërkuesi e ka ngritur pretendimin për cenimin e gjykatës së paanshme edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila ka arsyetuar se gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë vepruar në përputhje me nenin 260, pika 4, të KPP-së, pasi kërkesa e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit është paraqitur në kohën që ajo gjykatë apeli po shqyrtonte themelin e çështjes.

13. Në analizë të këtyre rrethanave, Kolegji konstaton se gjyqtarët e gjykatës së apelit kanë dhënë vendim për masën e sigurimit, bazuar në kërkesën e paraqitur nga kërkuesi gjatë fazës së gjykimit të çështjes, duke vepruar në këtë mënyrë në përputhje me procedurën e parashikuar nga neni 260, pika 4, i KPP-së, që parashikon se një kërkesë e tillë shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet. Me fjalë të tjera, ai trup gjykues nuk ka dhënë vendim për ndonjë kërkesë të ngritur gjatë fazës së hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, që do të thotë se argumenti i kërkuesit për shkeljen e nenit 15, pika 2, të KPP-së, nuk qëndron. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

14. Në lidhje me të drejtën për të mos u deklaruar fajtor bazuar në provat e mbledhura në mënyrë të paligjshme, Gjykata, në interpretim të nenit 32, pika 2, të Kushtetutës, ka theksuar se mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojnë se procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e “përmasës së

duhur të drejtësisë”, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Gjykatat e kanë për detyrë të vlerësojnë në tërësi nëse procedurat lidhur me mënyrën sesi janë siguruar provat kanë qenë të drejta (*shih vendimet nr. 67, datë 10.11.2017; nr. 7, datë 27.04.2005; nr. 95, datë 27.07.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka ngritur një sërë pretendimesh për mënyrën e marrjes së provave, por edhe për vlerësimin e përmbajtjes së tyre nga gjykatat e zakonshme. Konkretisht, sipas tij, gjatë hetimeve paraprake janë administruar deklaratimet e dy të bashkëpandehurve, të cilat nuk janë konfirmuar në seancë gjyqësore dhe nuk janë mbështetur në prova të tjera. Sipas tij, ai nuk është marrë në pyetje nga asnjë oficer i Policisë Gjyqësore, gjurmët e tij të gishtave nuk përputhen me ato të mbledhura dhe një gjurmë e gjetur nuk është identifikuar asnjëherë. Njohja e tij është kryer vetëm me anë të fotografive dhe jo drejtpërdrejt, sipas parashikimeve të nenit 172 të KPP-së. Po kështu, është përdorur si provë një përgjim ambiental i datës 30.10.2015, ku interpretohet sikur përmendet emri i kërkuesit, por ky përgjim përkon me datën e ndalimit të një shtetasi tjetër që njihet me të njëjtin emër dhe interpretimi është bërë pa pyetjen e kërkuesit, pa prova të tjera dhe pa transkriptim profesional që të vërtetojë lidhjen me të.

16. Nisur nga pretendimet e kërkuesit, Kolegji konstaton se ato që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave (vlerësimin e përmbajtjes së deklaratimeve të të bashkëpandehurve, të gjurmëve të gishtave, të përmbajtjes së përgjimit ambiental dhe të lidhjes që ato prova kanë me njëra-tjetrën), nuk mund të merren në shqyrtim, pasi nuk i përkasin juridiksionit kushtetues. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se vlerësimi i provave dhe mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet, nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Ndërsa për pretendimet për mënyrën e marrjes së provave (procedurën e marrjes së deklaratimeve të të bashkëpandehurve dhe atë të njohjes së kërkuesit), Kolegji evidenton se gjykatat e faktit nuk i kanë pranuar ato, duke arsyetuar se: (i) deklaratimet e të bashkëpandehurve janë administruar në gjykim në përputhje me nenin 370, pikat 1 dhe 2, të KPP-së, pasi janë dhënë në prani të mbrojtësve, të pandehurit janë hetuar në një procedim të lidhur dhe refuzonin të përgjigjeshin për deklaratimet hetimore të dhëna në prani të mbrojtësve; (ii) realizimi i procedurës së njohjes së kërkuesit me anë të fotografive i është imponuar organit procedues për shkak se ai ishte në mungesë, duke iu shmangur ndjekjes penale, ndaj ajo procedurë është në përputhje me nenet 171 e vijues të KPP-së. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar, ndër të tjera, se vendimet e gjykatave të faktit ishin të argumentuara dhe

nuk konstatohej zbatim i gabuar i ligjit procedural penal, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave.

18. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se interpretimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme për procedurën e marrjes së provave nuk duket i paarsyeshëm ose arbitrar për sa kohë nuk evidentohet ndonjë gabim ligjor ose faktik i dukshëm. Për pasojë, në të kundërt, me sa pretendon kërkuesi, nuk rezulton që ai të jetë deklaruar fajtor bazuar në prova të marra në mënyrë të paligjshme, ndaj pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.